



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1455/ 8 prot.

Datë 11/07/2025

V E N D I M
Nr. 896/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 11/07/2025, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “MUCA” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-43092-04-01-2025, me objekt: “BLERJE TAVOLINA PLASTIKE, STOLA PLASTIK, ÇIZME TË GJATA PUNE, PANDOFLA PLASTIKE PËR NEVOJA TË DPB.” me fond limit 36,651,600 (tridhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqindë) lekë pa TVSH dhe 369,509 (treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e nëntë) Euro pa TVSH, zhvilluar me datë 02.05.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.

Skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Laurenc Feracaku” Person Fizik, në procedurën e mësipërme të prokurimit

Ankimues: Operatori ekonomik “MUCA” SHPK me NIPT K01421002H, dhe me adresë: *Autostrada Tiranë - Durrës, km.13, Fshati Picar, Vorë Tiranë..*

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A
Adresa: Rruga “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337 (në krah të Gjykatës së Lartë), Tiranë.

Subjekte të interesuar: Operatori ekonomik “*Laurenc Feracaku*” Person Fizik me NIPT: K74304403K, dhe me adresë: *Lagjja “Karbunare e Poshtme” Rruga “Rrotondo e Savres”, Ndërtesë me numër pasurie 652/29, zk.2087, Lushnje, Fier.*

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.04.2025 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*E hapur, mbi kufirin e lartë monetar*”, me Nr. REF-43092-04-01-2025, me

objekt: “BLERJE TAVOLINA PLASTIKE, STOLA PLASTIK, ÇIZME TË GJATA PUNE, PANDOFLA PLASTIKE PËR NEVOJA TË DPB.” me fond limit 36,651,600 (tridhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqindë) lekë pa TVSH dhe 369,509 (treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e nëntë) Euro pa TVSH, zhvilluar me datë 02.05.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.

II.2. Në datë 02.05.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 19.05.2025 operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë njoftuar elektronikisht mbi klasifikimin përfundimtar të ofertave si vijon:

1	"ARTEO 218" SHPK	0,00	leke	skualifikuar
2	"Naim Hysi" PF	1.531.070,00	leke	skualifikuar
3	"Muca" SHPK	24.873.760,00	leke	skualifikuar
4	"Laurenc Feracaku" PF	25.836.000,00	leke	kualifikuar
5	BOE "AN&RA SHPK & UNIVERS PROMOTION SHPK"	28.952.000,00	leke	skualifikuar

II.4. Në datën 19.05.2025, operatori ekonomik “Muca” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentin si më poshtë vijon:

“Nuk përmbush pikën 2.3.4 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit për arsyen si më poshtë :

- Për artikullin 1 “Tavolinë plastike” operatori ekonomik në përmbushje të kriterit 2.3.3 ka paraqitur në SPE Katalog në të cilin deklaron që ky artikull është prodhuar nga prodhuesi “IPAE-PROGARDEN” S.p.a Itali, ndërsa gjatë verifikimit të mostrës së paraqitur nga OE nuk evidentohet dhe nuk konstatohet emërtim ose logo që të vërtetojë se kjo mostër është e prodhuar nga kompania prodhuese e paraqitur në katalog.
- Për artikullin 2 “Stola plastike” operatori ekonomik në përmbushje të kriterit 2.3.3 ka paraqitur në SPE Katalog në të cilin deklaron që ky artikull është prodhuar nga prodhuesi “Starplastik” Turqi, ndërsa gjatë verifikimit të mostrës së paraqitur nga OE nuk evidentohet dhe nuk konstatohet emërtim ose logo që të vërtetojë se kjo mostër është prodhuar nga kompania prodhuese e paraqitur në katalog.
- Për artikullin 3 “Pando fla verore (burrash/grash)” operatori ekonomik në përmbushje të kriterit 2.3.3 ka paraqitur në SPE Katalog në të cilin deklaron që ky artikull është prodhuar nga prodhuesi “Kajma” Shqipëri, ndërsa gjatë verifikimit të 2 mostrave të paraqitura nga OE, KVO konstatoji që pandoflat ngjyrë e zezë kanë të stampuar pas tyre “Made in China” pra janë prodhuar në Kinë ndërsa në pandoflat ngjyre blu nuk evidentohet dhe nuk konstatohet emërtim ose logo që të vërtetojë se kjo mostër është prodhuar nga kompania prodhuese e paraqitur në katalog.
- Për artikullin 4 “Çizme të gjata pune” operatori ekonomik në përmbushje të kriterit 2.3.3 ka paraqitur në SPE Katalog në të cilin deklaron që ky artikull është prodhuar nga prodhuesi “Greateagle Safetz Products” Kinë dhe ka bashkëngjitur në këtë katalog 2 pale çizme me logon “GGH” dhe “RTRMAX” të cilat i ka paraqitur dhe si mostra. KVO gjatë verifikimit të kodeve SS031 dhe SS030 në faqen ëb të kompanisë prodhuese “Greateagle Safetz Products”

Kinë <https://www.greateaglesafety.com/> të deklaruar nga OE në katalog, konstatoji që çizmet të cilat i përkasin këtyre kodeve nuk përmbajnë logot e deklaruar dhe paraqitura “GGH” dhe “RTRMAX”. Gjatë verifikimeve të metëjshme për mostrat e paraqitura evidentohet që kompania prodhuese e çizmeve me logon “RTRMAX” është kompania turke “RTRMAX” me seli në Turqi, ndërsa për çizmet me logon “GGH” nuk rezulton që të prodhohen nga kompania prodhuese “Greateagle Safetz Products” sipas dhe konstatimeve të mësipërme.”.

II.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronik konstatohet, se në datën 28.05.2025 autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke shpallur fitues shoqërinë “Laurenc Feracaku” PF.

II.6. Në datën 05.06.2025, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2025/5386 datë 05.06.2025, dhe me nr. 1455/2025 prot, datë 05.06.2025 e operatorit ekonomik “Muca” SHPK, me anë të së cilës kundërshtohet vendimmarrja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, si dhe kërkon skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Laurenc Feracaku” PF në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1455/1, datë 09.06.2025 lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Muca” SHPK, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij, si dhe për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Laurenc Feracaku” PF në procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Me shkresën nr. 1063/7 prot, datë 13.06.2025, protokolluar me tonën me nr. 1455/2 prot, datë 16.06.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues “Muca” SHPK, në të cilin konstatohet se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës nuk e ka pranuar ankesën e ankimuesit, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“...

II.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “MUCA” shpk mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tij, me arsyen se: “Nuk përmbush pikën 2.3.4 të Kriterëve të Veçanta të Kulifikimit, KSHA verën se:

Në nenin 40 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, pika 6, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar përcaktohet shprehimisht se: “Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si. Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë

kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.”.

Në Nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, pika 4, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

Në shtojcën 8/2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit” pika 2.3.3 dhe pika 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi përcaktohen kriteret si më poshtë:

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Këto dokumente duhet të përmbajnë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të kërkuara.

2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë në datën dhe orën e hapjes së procedurës së prokurimit nga një mostër për të gjitha artikujt objekt prokurimi.

- Mungesa e mostrës, është kusht për skualifikim.

- Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a në datën dhe orën e hapjes së procedurës së prokurimit, me adresë: Rr “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se operatori ekonomik ankimues në kuadër të plotësimit të kërkesës së përcaktuar sipas 2.3.3. të kapacitetit teknik të dokumenteve të tenderit ku citohet se: “Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Këto dokumente duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të kërkuara” ka paraqitur katalogun teknik përkatës.

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pasi mori në shqyrtim setin e plotë të dokumenteve të tenderit, dokumentacionin e paraqitur në sistemin e prokurimit elektronik si dhe mostrat

përkatëse nga operatori ekonomik ankimues “MUÇA” shpk konkludon se pretendimet e tij janë të pastrukturuara mbi bazë faktesh të legjitimuara dhe për rrjedhojë të padrejta.

Në kriteret e veçanta të dokumenteve të tenderit është përcaktuar se:

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë në datën dhe orën e hapjes së procedurës së prokurimit nga një mostër për të gjitha artikujt objekt prokurimi.

-Mungesa e mostrës, është kusht për skualifikim.

-Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a në datën dhe orën e hapjes së procedurës së prokurimit, me adresë: “Rr “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë).

Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe krieterëve për kualifikim, datë 01.04.2025, përcaktohet se:

Argumentimi: *Kërkesa për paraqitjen e mostrave si më sipër është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23. 12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Autoriteti kontraktor ka gjykuar të arsyeshme paraqitjen e mostrave për artikujt objekt prokurimi, të përcaktuara si më sipër, duke marrë në konsideratë sasinë e tyre, vlerën e fondit limit, llojin e mallit që kërkohet. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike dhe funksionale të përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit. Përfshirja e mostrave rrit transparencën dhe objektivitetin, duke i dhënë komisionit të vlerësimit një bazë të qartë për të krahasuar ofertat dhe për të marrë një vendim të drejtë. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tyre“, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tyre“, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.*

Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave nga verifikimi i katalogut përkatës teknik të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, si dhe nga verifikimi i mostrave përkatëse të paraqitura konkludohet se mos vendosja e logove përkatëse për identifikimin e prodhuesve respektivë për secilin artikull pjesë e specifikimeve teknike të dokumenteve të tenderit për procedurën objekt ankimimi, në thelb, është një tregues i pamundësisë për provimin e përputhshmërisë me specifikimet teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike dhe funksionale.

Lidhur me pretendimin konkret të operatorit ekonomik ankimues se: “në asnjë vend të DT nuk është kërkuar që mostrat e paraqitura duhet të kenë patjetër logo.”, KSHA thekson se është detyrë dhe barrë prove e operatorëve ekonomikë ofertues që të identifikojnë qartë produktin e paraqitur në cilësinë e mostrës, duke provuar gjithashtu edhe lidhjen me prodhuesit përkatës të referuar në fazën e para të ofertimit, konkretisht gjatë paraqitjes së katalogëve teknikë përkatës në sistemin e prokurimit elektronik.

KSHA thekson se vendosja e logos dhe emrit të prodhuesit në artikujt e kërkuar sipas specifikimeve teknike është e nevojshme dhe e arsyetuar për disa faktorë kryesorë që lidhen me transparencën, gjurmueshmërinë dhe përputhshmërinë teknike. Logoja ose emri i prodhuesit ndihmon autoritetin kontraktor që të kuptojë origjinën reale të produktit të ofruar. Ky fakt shmanget përdorimin e mostrave të jashtme (që mund të jenë të prodhuara nga prodhues të tjerë të pa evidentuar në fazën e parë të prokurimit, konkretisht në katalogun

përkatës) dhe garanton se operatori ekonomik ka paraqitur një produkt që është brenda kapaciteteve prodhuese të subjektit prodhues.

Pra, mungesa e logove përkatëse dhe emrave të prodhuesve tek mostrat e dorëzuara për artikujt përkatës tregon një mungesë koherence midis dokumentacionit dhe produktit të dorëzuar past kur paraqiten katalogë që përmbajnë emrin dhe të dhëna të tjera të prodhuesve është derivues dhe detyrues fakti që edhe mostrat të jenë të pajisura me këtë emërtim për të vërtetuar që artikulli fizik i ofruar i përket të njëjtit burim.

Për tepër, përveç mungesës së logos dhe emrit të prodhuesit është konstatuar se për artikullin 3 "Pandofla verore (burrash/grash)", operatori ekonomik ankimues në përmbushje të kriterit përcaktuar sipas pikës 2.3.3 të dokumenteve të tenderit, ka paraqitur në SPE dokumentin katalog në të cilin deklaron që ky artikull është prodhuar nga prodhuesi "Kajma" Shqipëri. Nga vlerësimi i Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ka rezultuar se pandoflat ngjyre e zezë kanë të stampuar pas tyre "Made in China" pra janë prodhuar në Kinë (fakt ky që bie në kundërshtim edhe me deklarin e berë sipas katalogut dhe dokumentit "Oferte teknike", të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në SPE) ndërsa në pandoflat ngjyrë blu nuk evidentohet dhe nuk konstatohet emërtim ose logo që të vërtetojë se kjo mostër është prodhuar nga kompania prodhuese e paraqitur në katalog.

KSHA konstaton jo vetëm një deklarin të pasaktë, por edhe një mospërputhje serioze dhe të provueshme objektivist, pasi emri i prodhuesit në katalog dhe ai në produkt janë të matshme, objektive dhe të verifikueshme. Ky nuk është një vlerësim subjektiv i cilësisë, por një fakt teknik që provon mospërputhje reale ndërmjet ofertës në formë të shkruar konkretisht katalogut teknik dhe artikullit/produktit fizik.

Në Nenin 37/2, të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", i ndyshuar, parashikohet shprehimisht se: "autoriteti ose enti kontraktor nuk e kërkon etiketën si të tillë, por mund të përcaktojë specifikimin teknik, duke iu referuar specifikimeve të detajuara të asaj etikete, ose, kur është e nevojshme, pjesëve të tyre, që lidhen me objektin e kontratës dhe janë të përshtatshme për të përcaktuar karakteristikat e këtij objekti.", pra qartazi në dokumentet e tenderit si dhe në procesverbalin e argumentimit të kriterëve për kualifikim është përcaktuar rëndësia e dëshmimit të përmbushjes së specifikimeve teknike dhe është në detyrën dhe barrën e provës së operatorit ekonomik ofertues përdorimi i instrumentit për realizimin e këtij qëllimi, konkretisht, etiketa/logo apo çdo formë tjetër e shkruar që tregon lidhjen midis prodhuesit të deklaruar në katalogun teknik dhe artikullit të dorëzuar fizikisht.

Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, autoriteti kontraktor ka të drejtë të refuzojë një ofertë kur ajo nuk përputhet me dokumentacionin teknik të paraqitur apo nuk ofron siguri të mjaftueshme për përmbushjen e kërkesave teknike. Në rastin konkret, mostra është objekt prove për këtë përputhshmëri.

Për sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Ndërsa lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "MUÇA" shpk lidhur me kualifikimin e operatorit ekonomik "Laurenc Feracaku" pf, i kualifikuar i pari, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konstaton se;

Në nenin 94, pika 1 të VKM 285, është parashikuar: "fdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur fnteres në një procedurë prokurimi sipas LPP-së, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik."

KSHA ka marrë në konsideratë duke trajtuar pretendimet e operatorit ekonomik ankimues që lidhen me pozicionin e tij në këtë procedurë prokurimi duke i refuzuar ato, dhe gjykon për mungesën e interesit të ligjshëm lidhur me pretendimet për operatorin ekonomik “Laurenc Feracaku” pf. Konkretisht, një nga kriteret themelore për legjitimitetin e një ankese është interesi i drejtpërdrejtë dhe personal që nënkupton që operatori ekonomik ankimues duhet të ketë një mundësi reale për të fituar kontratën, nëse ankesa do të pranohej. Në rastin konkret, operatori ekonomik për të cilin janë parashtruar pretendimet ankimese, edhe nëse do të skualifikohej, kjo nuk do të ndikonte në mundësinë e ankimesit për të fituar kontratën dhe në këtë kuadër operatori ekonomik ankimues nuk ka një interes të drejtpërdrejtë dhe të ligjshëm për të konstestuar këtë ofertë. Interesi ligjor matet në funksion të mundësisë për përfitim të kontratës dhe rezultati i pretenduar nga ankimesi nuk do e vendoste këtë të fundit në pozitën për të fituar kontratën, pra ankesa ndaj një operatori ekonomik me ofertë ekonomike më të lartë nuk e sjell këtë rezultat.

Gjithashtu në respektimi të parimit të ekonomisë dhe efikasitetit në prokurim, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave konsideron faktin që lejimi i ankesave nga operatorë ekonomikë me status të skualifikuar edhe pas shqyrtimit të pretendimeve lidhur me skualifikimin e tyre kundër operatorëve ekonomikë që nuk ndikojnë në renditje, shkakton zgjatje të panevojshme të procedurës.

Pra, operatori ekonomik ankimues nuk ka interes të ligjshëm në pretendimet e ngritura ndaj operatorit ekonomik “Laurenc Feracaku” pf, pasi nuk ka mundësi reale të përfitojë kontratën edhe nëse ankesa e tij pranohet, nuk ndikohet renditja e tij, nuk provohet shkelja ndaj tij në këtë ankesë dhe mungon ndikimi konkret në pozitën e tij juridike.

Për sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues lidhur me ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “Laurenc Feracaku” pf, nuk do të merren në shqyrtim.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 114 ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 102 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i ngarkuar për shqyrtimin e ankesës,

VENDOSI

1. Refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “MUÇA” shpk.
 2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
 3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
 4. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
- Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.”.

II.9. Me shkresën nr. 1455/4 prot., datë 01.07.2025 me objekt “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Muca” SHPK” Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur ka kërkuar nga autoriteti kontraktor mostrat e dorëzuara nga ana e ofertuesit “Muca” SHPK për artikulljt objekt prokurimi “Tavolinë plastike”, “Stola plastik”, “Pantofla plastike” dhe për artikullin objekt prokurimi “Cizme pune”, sipas kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.4 të shtojcën 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, si dhe informacioni e dokumentacioni vërtetues lidhur me dorëzimin e administrimin e mostrave të paraqitura nga ana e operatori ekonomik ofertues “Lorenc Feracaku” PF, në këtë procedurë prokurimi.

II.10. Me shkresën nr. 1063/9 prot, datë 04.07.2025, protokolluar me tonën me nr. 1455/5 prot, datë 04.07.2025, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik, mostrat e dorëzuara nga ana e ofertuesit “Muca” SHPK për artikulljt objekt prokurimi “Tavolinë plastike”, “Stola plastik”, “Pantofla plastike” dhe për artikullin objekt prokurimi “Cizme pune”, sipas kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.4 të shtojcën 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, si dhe procesverbali nr. 2, datë 02.05.2025 “Mbi evidentimin e paraqitjes dhe marrjen në dorëzim të kampioneve/mostrave/modeleve të ofertës teknike të ofertuesit “Lorenc Ferracaku” P.F” (2 fletë), ku ndër të tjera citohet si më poshtë vijon:

“Mbi evidentimin e paraqitjes dhe marrjes në dorëzim të kampioneve/mostrave/modeleve të ofertës teknike”

Të ofertuesit: Laurenc Feracaku

I mbajtur sot më datë 02.05.2025, ora 11:00 në organin qendror blerës Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, në prani të Operatorit Ekonomik, me qëllim evidentimin e dorëzimit të kampioneve/mostrave/ modeleve fizike të artikujve që kërkojnë të prokurohen, gjatë hapjes publike të ofertave të dorëzuara nga ofertuesi, për procedurën e prokurimit: “Procedurë e hapur”, mbi kufirin e lartë monetar - Mallra - Marrëveshje Kuadër, me objekt: Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër: “BLERJE TAVOLINA PLASTIKE, STOLA PLASTIK, ÇIZME TË GJATA PUNE, PANDOFLA PLASTIKE PËR NEVOJA TË DPB”, me fond limit: 36,651,600 (tridhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqindë) leke pa TVSH, me numër reference të procedurës kryesore REF-43092-04-01-2025.

Në zbatim të pikës 2.3.4 të Kriterëve të Veçanta për Kualifikim të DST, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë në datën dhe orën e hapjes së procedurës së prokurimit nga një mostër për të gjitha artikujt objekt prokurimi.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në datën 02.05.2025, ora 11.00, ftoi ofertuesin e pranishëm në hapjen publike të ofertave, i cili ka paraqitur ofertë nëpërmjet platformës elektronike të APP-së, të paraqesë nga një mostër për të gjitha artikujt objekt prokurimi, si vijon:

Nr.	Emërtimi i artikullit	Njësia	Sasia
1	Tavolina Plastike	Copë	1
2	Stola plastik	Copë	1
3	Pantofla plastike	Copë	1
4	Çizme pune	Copë	1

... ”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatori ekonomik “MUCA” SHPK mbi kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi si në vijim: “Nuk përmbush pikën 2.3.4 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit për arsyen si më poshtë :

- Për artikullin 1 “Tavolinë plastike” operatori ekonomik në përmbushje të kriterit 2.3.3 ka paraqitur në SPE Katalog në të cilin deklaron që ky artikull është prodhuar nga prodhuesi “IPAE-PROGARDEN” S.p.a Itali, ndërsa gjatë verifikimit të mostrës së paraqitur nga OE nuk evidentohet dhe nuk konstatohet emërtim ose logo që të vërtetojë se kjo mostër është e prodhuar nga kompania prodhuese e paraqitur në katalog.
- Për artikullin 2 “Stola plastikë” operatori ekonomik në përmbushje të kriterit 2.3.3 ka paraqitur në SPE Katalog në të cilin deklaron që ky artikull është prodhuar nga prodhuesi “Starplastik” Turqi, ndërsa gjatë verifikimit të mostrës së paraqitur nga OE nuk evidentohet dhe nuk konstatohet emërtim ose logo që të vërtetojë se kjo mostër është prodhuar nga kompania prodhuese e paraqitur në katalog.
- Për artikullin 3 “Pandofla verore (burrash/grash)” operatori ekonomik në përmbushje të kriterit 2.3.3 ka paraqitur në SPE Katalog në të cilin deklaron që ky artikull është prodhuar nga prodhuesi “Kajma” Shqipëri, ndërsa gjatë verifikimit të 2 mostrave të paraqitura nga OE, KVO konstatoji që pandoflat ngjyrë e zezë kanë të stampuar pas tyre “Made in China” pra janë prodhuar në Kinë ndërsa në pandoflat ngjyre blu nuk evidentohet dhe nuk konstatohet emërtim ose logo që të vërtetojë se kjo mostër është prodhuar nga kompania prodhuese e paraqitur në katalog.
- Për artikullin 4 “Çizme të gjata pune” operatori ekonomik në përmbushje të kriterit 2.3.3 ka paraqitur në SPE Katalog në të cilin deklaron që ky artikull është prodhuar nga prodhuesi “Greateagle Safetz Products” Kinë dhe ka bashkëngjitur në këtë katalog 2 pale çizme me logon “GGH” dhe “RTRMAX” të cilat i ka paraqitur dhe si mostra. KVO gjatë verifikimit të kodeve SS031 dhe SS030 në faqen e të kompanisë prodhuese “Greateagle Safetz Products” Kinë <https://ëë.greateaglesafety.com/> të deklaruar nga OE në katalog, konstatoji që çizmet të cilat i përkasin këtyre kodeve nuk përmbajnë logot e deklaruar dhe paraqitura “GGH”

dhe “RTRMAX”. Gjatë verifikimeve të metëjshme për mostrat e paraqitura evidentohet që kompania prodhuese e çizmeve me logon “RTRMAX” është kompania turke “RTRMAX” me seli në Turqi, ndërsa për çizmet me logon “GGH” nuk rezulton që të prodhohen nga kompania prodhuese “Greateagle Safetz Products” sipas dhe konstatimeve të mësipërme.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 2.3.3 dhe pika 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriteret kualifikuese si më poshtë vijon:

“3. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët/ fragmente të katalogut ose skedat teknike për të gjitha artikujt objekt prokurimi. Këto dokumente duhet të përmbajë karakteristikat teknike të specifikimeve teknike të kërkuar në dokumentet e tenderit, me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të kërkuara.

4. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë në datën dhe orën e hapjes së procedurës së prokurimit nga një mostër për të gjitha artikujt objekt prokurimi.

-Mungesa e mostrës, është kusht për skualifikim.

-Mostrat do të paraqiten pranë Autoritetit Kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara sh.a në datën dhe orën e hapjes së procedurës së prokurimit, me adresë: Rr “Reshit Çollaku”, Godina Nr.6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë). “.

III.1.2. Në shtojcën 6 “FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike të artikujve objekt prokurimi, si më poshtë vijon:

Shtojca 6.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët “ose ekuivalent”.

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;

b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit në mjedis;

c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës. Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

OBJEKTI: "BLERJE TAVOLINA PLASTIKE, STOLA PLASTIK, ÇIZME TË GJATA PUNE, PANTOFLA PLASTIKE"

Specifikime Teknike për "Tavolina plastike, stola plastik, çizme të gjata pune, pantofla plastike, për nevoja të DPB-së".

1. Tavolinë plastike

Tavolinë e palosshme, polipropilen, 79 x 72 x 70 cm (**± 2 cm**). Tavolina të jetë plastike me ngjyrë jeshile të errët, gri e errët etj, me formë elegante, të ketë komoditet në qëndrim. Materiali plastik të jetë i lehtë dhe rezistent ndaj lagështisë dhe agjentëve atmosferikë. Dizajni i kësaj tavoline të përshtatet lehtë me të gjitha ambientet. **(sipas skicës të ilustruar në fotën e mëposhtme).**

- Materiali: polipropilen
- Ngjyra: jeshile errët, gri e errët
- Lartësia: 70 cm
- Gjerësia: 79 cm
- Gjatësia: 72 cm



2. Stola plastikë 30 cm × 30 cm × 45 cm (h)(± 2 cm).

Stolat: materiali polipropilen me katër këmbë, të përshtatshme për përdorim me tavolinat e mësipërme. Struktura (e gjithë sipërfaqja e stolit, këmbët... etj) të jetë me dizajnë thurje.

Pjesa e këmbëve në fund të jetë lidhur në mënyrë monolide që të përforcojë rezistencën e stolit. (sipas skicës të ilustruar ne fotën e mëposhtme).

Kërkesat cilësore dhe përmasat e stolave të jenë si më poshtë:

- *Materiali: polipropilen plastikë cilësore dhe e qëndrueshëm.*
- *Stolat të jenë rezistentë ndaj goditjeve.*
- *Përmasat: 30 cm × 30 cm × 45 cm (h) (± 2 cm).*
- *Ngjyra: jeshile errët, gri e errët, etj.*



3. Pandofla verore (burrash/grash)

Të jenë material material plastik me gomë poroze dhe pjesa e përparme të jetë e hapur. Materiali të jetë antirrëshqites, rezistent ndaj gërryerjes së vajit dhe i padepërtueshëm nga uji. Të jenë me ngjyra të errëta si: e zezë, gri e errët. Të jenë burrash/grash sipas kërkesës së AK.

Saktësime të tjera përta i përket numrave sipas gjinisë do të bëhen në momentin e lidhjes së kontratës.

4. Çizme të gjata pune PVC

Të jenë me material elastik PVC-je me veshje poliester brenda. Goma të jetë antiabrazive dhe anti rrëshqitëse.

Pjesa e sipërme të jetë e padepërtueshme nga uji dhe rezistente ndaj diellit.

Ngjyra të jetë e zezë, gri e errët.

Saktësime të tjera për numrat sipas gjinisë do të bëhen me lidhjen e kontratës.

Furnizimi i artikujve të sipër cituar do të bëhet në magazinat e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve në IEVP Vaqarr.

Furnizimi do të fillojë me lidhjen e kontratës, dhe do të vazhdojë për çdo vit me kërkesë paraprake sipas nevojave të AK.

Çdo standard i kërkuar apo çdo referencë marke të mallrave objekt prokurimi, autoriteti kontraktor do të pranojë edhe ekuivalentin e tij.

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike dhe referuar shkresës nr. 1063/9 prot, datë 04.07.2025, protokolluar me tonën me nr. 1455/5 prot, datë 04.07.2025, rezulton, se operatori ekonomik “MUCA” SHPK për plotësimin e kriterëve kualifikuese të përcaktuar në shtojcën 8 “Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” pika 2.3. dhe pika 2.3.4 “Kapaciteti teknik” ka dorëzuar dokumentacionin dhe mostrat, si më poshtë vijon:

- *Skedë teknike të artikullit “TAVOLINË PLASTIKE” të prodhuesit “IPAE-PROGARDEN S.P.A– Itali”.*
- *Skedë teknike të artikullit “STOLA PLASTIKË” të prodhuesit “STARSPLASTIK – Turqi”.*
- *Skedë teknike të artikullit “ÇIZME TË GJATA PUNE PVC” të prodhuesit GREATEAGLE SAFETZ PRODUCTS – Kinë”.*
- *Skedë teknike të artikullit “PANDOFLA VERORE” të prodhuesit “KAJMA – Shqipëri”.*

Mostra të produkteve të ofruara, si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i artikullit	Njësia	Sasia
1	Tavolina Plastike	Copë	1
2	Stola plastik	Copë	1
3	Pantofla plastike (njgjyë e zezë)	Copë	1
4	Pantofla plastike (njgjyë blu)	Copë	1
5	Çizme pune (ngjyrë e zezë)	Copë	1
6	Çizme pune (ngjyrë e bardhë)	Copë	1

III.1.4. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.*

III.1.5. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.*
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.*
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”.*

III.1.6. Në nenin 77 pika 1, 4 dhe 5 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet.*

Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve.”.

III.1.7. Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose

enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji. Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.”.

III.1.8. Në nenin 40 pika 6 germa a) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:
a) Mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar, si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose

c) dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.

III.1.9. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i

ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.10. Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, vërejmë se kriteret kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.3.3 dhe pikën 2.3.4 “*Kapaciteti teknik*” të Shtojcës 8 “*Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë me njëri tjetrin ndaj dhe Komisioni në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “MUCA” SHPK, si dhe dokumentacionit dhe mostrave të dorëzuar nga operatori ekonomik ofertues “MUCA” SHPK për përbushjen e këtyre kriterëve do ti referohet në total kriterëve, pasi përbushja apo mospërbushja e tyre lidhet me secili kriter.

III.1.11. Fillimisht KPP, gjykon të ndalet në një analizë të thelluar të kërkesave kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.3.3 dhe pikën 2.3.4 “*Kapaciteti teknik*” të përcaktuara në shtojcën 8 “*Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit*” të dokumentave të tenderit të të procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Në shtojcën 6 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar specifikimet teknike të artikujve objekt prokurimi si në vijim: “*Tavolinë plastike; Stol plastik; Pantofla plastike (njygyjë e zezë); Pantofla plastike (njygyjë blu); Çizme pune (ngjyrë e zezë) dhe Çizme pune (ngjyrë e bardhë).*”.

Në kriterin kualifikues të përcaktuar në 2.3.3 “*Kapaciteti teknik*” të përcaktuara në shtojcën 8 “*Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogët ose fragmente të katalogut ose skedat teknike për secilin nga produktet objekt prokurimi të ofruara nga ana e ofertuesit referuar produkteve objekt prokurimi të përcaktuara në shtojcën 6 “*FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE*” të dokumentave të tenderit, me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë nëse produktet e ofruara i plotësojnë ose jo specifikimet teknike të produkteve objekt prokurimit të përcaktuara në këtë shtojcë.

Njëkohësisht në kriterin kualifikues të përcaktuar në 2.3.4 “*Kapaciteti teknik*” të përcaktuara në shtojcën 8 “*Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes/Kualifikimit*” të dokumentave të tenderit, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që për produktet e ofruara dhe për të cilët ka paraqitur katalogët ose fragmente të katalogut ose skedat teknike, njëkohësisht duhet

që të paraqesë didtën dhe orën e hapjes së procedurës së prokurimit objekt ankimi, nga 1 (një) mostër për secilin prej artikujt e ofruar dhe për të cilët ka paraqitur katalogët ose fragmente të katalogut ose skedat teknike.

III.1.12.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “MUCA” SHPK përsa i përket arsyes së skualifikimit si në vijim; “• Për artikullin 1 “Tavolinë plastike” operatori ekonomik në përmbushje të kriterit 2.3.3 ka paraqitur në SPE Katalog në të cilin deklaroi që ky artikull është prodhuar nga prodhuesi “IPAE-PROGARDEN” S.p.a Itali, ndërsa gjatë verifikimit të mostrës së paraqitur nga OE nuk evidentohet dhe nuk konstatohet emërtim ose logo që të vërtetojë se kjo mostër është e prodhuar nga kompania prodhuese e paraqitur në katalog.” Komisioni konstaton se për plotësimin e kriterëve kualifikuesë të përcaktuara në pikën 2.3.3 dhe pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të përcaktuara në shtojcën 8 “Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, operatori ekonomik ofertues “MUCA” SHPK ka paraqitur skedën teknike të artikullit “Tavolinë plastike” të ofruar, ku konstatohet se ky artikull është prodhuar nga kompania prodhuese “IPAE-PROGARDEN” S.P.A, Itali, si dhe ka paraqitur mostrën e këtij produkti të ofruar, ku konstatohet se është i etiketuar dhe nga kqyrja e etiketës konstatohet se produktit është i prodhuar nga kompania italiane “IPAE-PROGARDEN” S.P.A.

Nisur nga sa më sipër, referuar kërkesës së autoritetit kontraktor të përcaktuar në pikën 2.3.3 dhe pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 8 “FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, si dhe dokumentacionit dhe mostrës së dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ofertues “MUCA” SHPK për artikullin objekt prokurimi “Tavolinë plastike”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ky i fundit i plotëson kriteret kualifikuesë të sipërpërmendura dhe arsyeja e skualifikimit nuk qëndron, pasi për produktin objekt prokurimi “Tavolinë plastike” ka ofruar produkt të kompanisë prodhuese italiane “IPAE-PROGARDEN” S.P.A evërtetuar nëpërmjet skedës teknike të dorëzuar në dokumentacionin e ofertës dhe njëkohësisht për këtë produkt të ofruar ka paraqitur edhe mostrën e këtij produkti të prodhuar nga kompania prodhuese italiane “IPAE-PROGARDEN” S.P.A.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “MUCA” SHPK qëndron.

III.1.12.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “MUCA” SHPK përsa i përket arsyeve të skualifikimit si në vijim: “• Për artikullin 2 “Stola plastikë” operatori ekonomik në përmbushje të kriterit 2.3.3 ka paraqitur në SPE Katalog në të cilin deklaroi që ky artikull është prodhuar nga prodhuesi “Starplastik” Turqi, ndërsa gjatë verifikimit të mostrës së paraqitur nga OE nuk evidentohet dhe nuk konstatohet emërtim ose logo që të vërtetojë se kjo mostër është prodhuar nga kompania prodhuese e paraqitur në katalog.

• Për artikullin 3 “Pandofla verore (burrash/grash)” operatori ekonomik në përmbushje të kriterit 2.3.3 ka paraqitur në SPE Katalog në të cilin deklaroi që ky artikull është prodhuar nga prodhuesi “Kajma” Shqipëri, ndërsa gjatë verifikimit të 2 mostrave të paraqitura nga OE, KVO konstatoi që pandoflat ngjyrë e zezë kanë të stampuar pas tyre “Made in China” pra janë prodhuar në Kinë ndërsa në pandoflat ngjyre blu nuk evidentohet dhe nuk konstatohet emërtim ose logo që të vërtetojë se kjo mostër është prodhuar nga kompania prodhuese e paraqitur në katalog.” Komisioni konstaton se për plotësimin e kriterëve

kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.3.3 dhe pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të përcaktuara në shtojcën 8 “Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, operatori ekonomik ofertues “MUCA” SHPK ka paraqitur skedën teknike të artikullit “Stola plastikë” të ofruar, ku konstatohet se ky artikull është prodhuar nga kompania prodhuese “STARSPLASTIK” në Turqi, si dhe ka dorëzuar mostrën për këtë artikull, por nga verifikimi i mostrës të dorëzuara pranë Komisionit Prokurimit Publik nga ana e autoritetit kontraktor konstatohet se ka mospërputhje midis tyre dhe prodhuesve të deklaruar referuar skedës teknike, pasi nga verifikimi i mostrës së dorëzuar nuk identifikohet prodhuesi i saj.

Pra nga sa më sipër cituam rezulton se nga njëra anë përse i përket plotësimit të kriterit të përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik” operatori ekonomik ankimues “MUCA” SHPK ka paraqitur skedën teknike të artikullit “Stola plastikë” të ofruar nga prodhuesi “STARSPLASTIK”, ndërkohë që mostrën e dorëzuar të artikullit “Stola plastikë” rezulton se nuk identifikohet që prodhuesi i kësaj mostre të jetë kompania turke “STARSPLASTIK”, pasi mostra nuk ka snjë etiketë ose shënjë identifikuese të prodhuesit.

KPP nga shqyrtimi i mostrës të operatorit ekonomik ankimues “MUCA” SHPK, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP-së, konstaton se ky i fundit ka dorëzuar 1 (një) mostër, për artikullin objekt prokurimi “Stola plastikë”, ku nuk identifikohet prodhuesi kësaj mostee, ndërkohë që referuar skedës teknike të dorëzuar për këtë artikull rezulton se prodhes është kompania turke “STARSPLASTIK”, duke mos dhënë asnjë të dhënë që msotra e dorëzuar është e prodhuesit të deklaruar.

Pra, sa më sipër, nuk krijohet asnjë lidhje midis mostrës së dorëzuar dhe dokumentit si skeda teknike të produktit të dorëzuar në SPE, si dhe midis mostrave dhe prodhuesit të deklaruar nga operatori ekonomik “MUCA” SHPK. Në këtë rast rezulton, se produkti i ofruar sipas skedës teknike nuk është i njëjtë me mostrën e dorëzuar nga ofertuesi në këtë procedurë.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se mostra e dorëzuar për artikullin e ofruar “Stola plastik” nga ana e operatorit ekonomik ankimues “MUCA” SHPK nuk është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Referuar legjislacionit në fuqi, mostra i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik disponon kapacitete për të siguruar produktin sipas specifikimeve të kërkuara. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “MUCA” SHPK nuk e ka plotësuar kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, në lidhje me paraqitjen e mostrave, pasi ka mospërputhje midis mostrës së dorëzuar për artikullin objekt prokurimi “Stola plastik” me produktin e deklaruar në skedën teknike të prodhuesit, i cili nuk mund të identifikohet se i përket prodhuesit të deklaruar në skedën teknike të dorëzuar në SPE. KPP gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Nisur nga sa më sipër, referuar kërkesës së autoritetit kontraktor të përcaktuar në pikën 2.3.3 dhe pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të shtojcës 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, si dhe dokumentacionit dhe mostrës së dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ofertues “MUCA” SHPK për artikullin objekt prokurimi “*Stola plastik*”, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ky i fundit nuk i plotëson kriteret kualifikuese të sipërpërmendura dhe arsyeja e skualifikimit qëndron, pasi për produktin objekt prokurimi “*Stola plastik*” ka ofruar produkt të kompanisë prodhuese turke “*STARSPLASTIK*” e vërtetuar nëpërmjet skedës teknike të dorëzuar në dokumentacionin e ofertës dhe njëkohësisht për këtë produkt të ofruar ka paraqitur mostrën e këtij produkti ku nuk mund të identifikohet se prodhues është kompania prodhuese turke “*STARSPLASTIK*”.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “MUCA” SHPK nuk qëndron.

III.1.12.3. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “MUCA” SHPK përsa i përket arsyeve të skualifikimit si në vijim: “• *Për artikullin 3 “Pandofla verore (burrash/grash)” operatori ekonomik në përmbushje të kriterit 2.3.3 ka paraqitur në SPE Katalog në të cilin deklaron që ky artikull është prodhuar nga prodhuesi “Kajma” Shqipëri, ndërsa gjatë verifikimit të 2 mostrave të paraqitura nga OE, KVO konstatoji që pandoflat ngjyrë e zezë kanë të stampuar pas tyre “Made in China” pra janë prodhuar në Kinë ndërsa në pandoflat ngjyre blu nuk evidentohet dhe nuk konstatohet emërtim ose logo që të vërtetojë se kjo mostër është prodhuar kompania prodhuese e paraqitur në katalog.*”, Komisioni konstaton se për plotësimin e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.3.3 dhe pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të përcaktuara në shtojcën 8 “*Formulari i Krieteve të Përzgjedhjes/Kualifikimit*” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, operatori ekonomik ofertues “MUCA” SHPK ka paraqitur skedën teknike të artikullit “*Pandofla verore (burrash/grash)*” të ofruar, ku konstatohet se ky artikull është prodhuar nga kompania prodhuese “Kajma” në Shqipëri, si dhe ka dorëzuar 2 (dy) mostra për këta artikuj, por nga verifikimi i mostrave të dorëzuara pranë Komisionit Prokurimit Publik nga ana e autoritetit kontraktor konstatohet se ka mospërputhje midis tyre dhe prodhuesve të deklaruar referuar skedës teknike, pasi nga verifikimi i mostrës së dorëzuar nuk identifikohet prodhuesi i saj.

Pra nga sa më sipër cituam rezulton se nga njëra anë përsa i përket plotësimit të kriterit të përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik” operatori ekonomik ankimues “MUCA” SHPK ka paraqitur skedën teknike të artikullit “*Pandofla verore (burrash/grash)*” të ofruar nga prodhuesi “Kajma”, ndërkohë që mostrat e dorëzuar të artikullit “*Pandofla verore (burrash/grash)*” rezulton se nuk identifikohet që prodhues i këtyre mostrave të jetë kompania shqiptare “Kajma”, pasi mostrat nuk ka snjë etiketë ose shënjë identifikuese të prodhuesit.

KPP nga shqyrtimi i mostrës të operatorit ekonomik ankimues “MUCA” SHPK, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP-së, konstaton se ky i fundit ka dorëzuar 2 (dy) mostra, për artikullin objekt prokurimi “*Pandofla verore (burrash/grash)*”, ku nuk identifikohet prodhuesi këtyre mostrave, ndërkohë që referuar skedës teknike të dorëzuar për këtë artikull rezulton se prodhues është kompania shqiptare “Kajma”, duke mos dhënë asnjë të dhënë që msotrat e dorëzuara janë të prodhuesit të deklaruar.

Pra, sa më sipër, nuk krijohet asnjë lidhje midis mostrave së dorëzuara dhe dokumentit skeda teknike të produkteve të dorëzuara në SPE, si dhe midis mostrave dhe prodhuesit të deklaruar nga operatori ekonomik “MUCA” SHPK. Në këtë rast rezulton, se produkti i ofruar sipas skedës teknike nuk është i njëjtë me mostrat e dorëzuar nga ofertuesi në këtë procedurë.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se mostrat e dorëzuara për artikullin e ofruar “*Pandofla verore (burrash/grash)*” nga ana e operatori ekonomik ankimues “MUCA” SHPK nuk janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Referuar legjislacionit në fuqi, mostra i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik disponon kapacitete për të siguruar produktin sipas specifikimeve të kërkuara. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “MUCA” SHPK nuk e ka plotësuar kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, në lidhje me paraqitjen e mostrave, pasi ka mospërputhje midis mostrave të dorëzuara për artikullin objekt prokurimi “*Pandofla verore (burrash/grash)*” me produktin e deklaruar në skedën teknike të prodhuesit, i cili nuk mund të identifikohet se i përket prodhuesit të deklaruar në skedën teknike të dorëzuar në SPE. KPP gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Nisur nga sa më sipër, referuar kërkesës së autoritetit kontraktor të përcaktuar në pikën 2.3.3 dhe pikën 2.3.4 “*Kapaciteti teknik*” të shtojcës 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, si dhe dokumentacionit dhe mostrës së dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ofertues “MUCA” SHPK për artikullin objekt prokurimi “*Pandofla verore (burrash/grash)*” Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ky i fundit nuk i plotëson kriteret kualifikuese të sipërpërmendura dhe arsyeja e skualifikimit qëndron, pasi për produktin objekt prokurimi “*Pandofla verore (burrash/grash)*” ka ofruar produkt të kompanisë prodhuese shqiptare “*Kajma*” e vërtetuar nëpërmjet skedës teknike të dorëzuar në dokumentacionin e ofertës dhe njëkohësisht për këtë produkt të ofruar ka paraqitur mostrat e këtij produkti ku nuk mund të identifikohet se prodhues është kompania prodhuese shqiptare “*Kajma*”.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “MUCA” SHPK nuk qëndron.

III.1.12.4. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “MUCA” SHPK përsa i përket arsyeve të skualifikimit si në vijim: “• Për artikullin 4 “*Çizme të gjata pune*” operatori ekonomik në përmbushje të kriterit 2.3.3 ka paraqitur në SPE Katalog në të cilin deklaron që ky artikull është prodhuar nga prodhuesi “*Greateagle Safetz Products*” Kinë dhe ka bashkëngjitur në këtë katalog 2 pale çizme me logon “GGH” dhe “RTRMAX” të cilat i ka paraqitur dhe si mostra. KVO gjatë verifikimit të kodeve SS031 dhe SS030 në faqen web të kompanisë prodhuese “*Greateagle Safetz Products*” Kinë <https://ëëë.greateaglesafety.com/> të deklaruar nga OE në katalog, konstatoji që çizmet të cilat i përkasin këtyre kodeve nuk përmbajnë logot e deklaruar dhe paraqitura “GGH” dhe “RTRMAX”. Gjatë verifikimeve të

metëjshme për mostrat e paraqitura evidentohet që kompania prodhuese e çizmeve me logon “RTRMAX” është kompania turke “RTRMAX” me seli në Turqi, ndërsa për çizmet me logon “GGH” nuk rezulton që të prodhohen nga kompania prodhuese “Greateagle Safetz Products” sipas dhe konstatimeve të mësipërme.”, Komisioni konstaton se për plotësimin e kriterëve kualifikuese të përcaktuara në pikën 2.3.3 dhe pikën 2.3.4 “Kapaciteti teknik” të përcaktuara në shtojcën 8 “Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes/Kualifikimit” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, operatori ekonomik ofertues “MUCA” SHPK ka paraqitur skedën teknike të artikullit “Çizme të gjata pune” të ofruar, ku konstatohet se ky artikull është prodhuar nga kompania prodhuese “Greateagle Safetz Products” në Kinë, si dhe ka dorëzuar 2 (dy) mostra për këtë artikull, por nga verifikimi i mostrave të dorëzuara pranë Komisionit Prokurimit Publik nga ana e autoritetit kontraktor konstatohet se ka mospërputhje midis tyre dhe prodhuesve të deklaruar referuar skedës teknike, pasi nga verifikimi i mostrave të dorëzuara nuk identifikohet prodhuesi i saj. Pra nga sa më sipër cituam rezulton se nga njëra anë përse i përket plotësimit të kriterit të përcaktuar nga ana e autoritetit kontraktor në pikën 2.3.3 “Kapaciteti teknik” operatori ekonomik ankimues “MUCA” SHPK ka paraqitur skedën teknike të artikullit “Çizme të gjata pune” të ofruar nga prodhuesi “Greateagle Safetz Products”, ndërkohë që mostrat e dorëzuara të artikullit “Çizme të gjata pune” rezulton se nuk identifikohet që prodhues i këtyre mostrave të jetë kompania kineze “Greateagle Safetz Products”, pasi mostrat nuk ka snjë etiketë ose shënjë identifikuese të prodhuesit.

KPP nga shqyrtimi i mostrës të operatorit ekonomik ankimues “MUCA” SHPK, të dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë KPP-së, konstaton se ky i fundit ka dorëzuar 2 (dy) mostra, për artikullin objekt prokurimi “Çizme të gjata pune”, ku nuk identifikohet prodhuesi këtyre mostrave, ndërkohë që referuar skedës teknike të dorëzuar për këtë artikull rezulton se prodhues është kompania kineze “Greateagle Safetz Products”, duke mos dhënë asnjë të dhënë që mostrat e dorëzuara janë të prodhuesit të deklaruar.

Pra, sa më sipër, nuk krijohet asnjë lidhje midis mostrave së dorëzuara dhe dokumentit skeda teknike të produkteve të dorëzuara në SPE, si dhe midis mostrave dhe prodhuesit të deklaruar nga operatori ekonomik “MUCA” SHPK. Në këtë rast rezulton, se produkti i ofruar sipas skedës teknike nuk është i njëjtë me mostrat e dorëzuar nga ofertuesi në këtë procedurë.

Sa më lart, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se mostrat e dorëzuara për artikullin e ofruar “Çizme të gjata pune” nga ana e operatorit ekonomik ankimues “MUCA” SHPK nuk janë në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Referuar legjislacionit në fuqi, mostra i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik disponon kapacitete për të siguruar produktin sipas specifikimeve të kërkuara. Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “MUCA” SHPK nuk e ka plotësuar kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, në lidhje me paraqitjen e mostrave, pasi ka mospërputhje midis mostrave të dorëzuara për artikullin objekt prokurimi “Çizme të gjata pune” me produktin e deklaruar në skedën teknike të prodhuesit, i cili nuk mund të identifikohet se i përket prodhuesit të deklaruar në skedën teknike të dorëzuar në SPE. KPP gjykon, se është detyrim ligjor i subjektit ofertues të provojë me dokumentacion të plotë dhe në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor, plotësimin e kriterëve të kërkuara në dokumentet e tenderit, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Akoma më tej KPP sqaron, se në një procedurë prokurimi, subjekti i parë i interesuar është operatori ekonomik, i cili e përgatit

ofertën e tij në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe nga ana tjetër, është autoriteti kontraktor, i cili përzgjedh operatorin ekonomik që plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Nisur nga sa më sipër, referuar kërkesës së autoritetit kontraktor të përcaktuar në pikën 2.3.3 dhe pikën 2.3.4 “*Kapaciteti teknik*” të shtojcës 8 “*FORMULARI I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT*” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, si dhe dokumentacionit dhe mostrës së dorëzuar nga ana e operatorit ekonomik ofertues “*MUCA*” SHPK për artikullin objekt prokurimi “*Çizme të gjata pune*” Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ky i fundit nuk i plotëson kriteret kualifikuese të sipërpërmendura dhe arsyeja e skualifikimit qëndron, pasi për produktin objekt prokurimi “*Çizme të gjata pune*” ka ofruar produkt të kompanisë prodhuese kineze “*Greateagle Safetz Products*” e vërtetuar nëpërmjet skedës teknike të dorëzuar në dokumentacionin e ofertës dhe njëkohësisht për këtë produkt të ofruar ka paraqitur mostrat e këtij produkti ku nuk mund të identifikohet se prodhues është kompania prodhuese kineze “*Greateagle Safetz Products*”.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “*MUCA*” SHPK nuk qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*MUCA*” SHPK në lidhje me kualifikimin e operatorit ekonomik “*Laurenc Feracaku*” Person Fizik në këtë procedurë prokurimi, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se,

III.2.1. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “*Afatet për ankimim*” të Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se:

“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj në Sistemin Elektronik të Ankesave. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.2.2. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik në Sistemin e Ankesave Elektronike.

Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.2.3. Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, parashikohet:

“1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes të ligjshëm në një procedurë prokurimi sipas LPP-së, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe komisionit të prokurimit publik.”.

III.2.4. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë), se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik, me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. Neni 94, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor. Referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, duhet të plotësohen dy kushte kumulative: (legjitimimi *locus standi*), interesi i ligjshëm për të marrë një kontratë, ose dëmtimi apo rreziku për t’u dëmtuar nga një shkelje e pretenduar.

III.2.5. I vetmi interes i ligjshëm, që mund të ketë një operator ekonomik i dëmtuar nga një vendim i një autoriteti kontraktor, i dhënë në kuadrin e një procedure prokurimi është që përmes ankimit, ai të fitojë kontratën. Në ato raste kur, operatori ekonomik ankimues edhe pas ankimit rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit, atëherë ai qartësisht nuk mund ta fitojë kontratën. Edhe në hipotezën, se pretendimet e parashtruara në ankimin e tij në lidhje me operatorët e tjerë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, do të pranohen nga KPP, ankimuesi sërish nuk do të ishte fitues i kontratës.

Rrjedhimisht, në rast se operatori ekonomik që ka paraqitur ankimin, vijon të mbetet i skualifikuar apo skualifikohet gjatë shqyrtimit në KPP, në kuptim të ligjit, interesi i tij i ligjshëm, i drejtpërdrejtë e real (*përkundrejt atij imagjinar*), nuk ka sesi të dëmtohet nga suksesi apo dështimi i operatorëve të tjerë në atë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues nuk merren në shqyrtim.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”* i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 *“Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”*, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të

Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19” Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “MUCA” ShPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me Nr. REF-43092-04-01-2025, me objekt: “BLERJE TAVOLINA PLASTIKE, STOLA PLASTIK, ÇIZME TË GJATA PUNE, PANDOFLA PLASTIKE PËR NEVOJA TË DPB.” me fond limit 36,651,600 (tridhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqindë) lekë pa TVSH dhe 369,509 (treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e nëntë) Euro pa TVSH, zhvilluar me datë 02.05.2025, nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara SH.A.
 2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë procedurën e prokurimit, duke rishikuar arsyet e skualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “MUCA” ShPK.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
 4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “MUCA” ShPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

